



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
Nr.04-*M/01-19647* /2017
Kaçanik, 16.06.2017

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mesirndhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10 në
Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale

I. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10, të gjimnazit dhe shkollës profesionale, për vitin shkollor 2017/18, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10 në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron),
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Certifikatën e lindjes.

Mënyra e aplikimit dhe shpallja e rezultateve

Konkursi do të jetë i hapur nga data 19 deri më 23 Qershor

Aplikimi do të bëhet në shkollën përkatëse duke filluar nga ora 8:00 deri 16:00.

Rezultatet shpallen më 27 Qershor në shkollën përkatëse.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë brenda 24 crëve, nga koha e shpalljes së rezultateve, t'i paraqes ankesë Drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT – it, komisionit për ankesa.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10 duhet t'i plotësojnë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
 3. Numri i pikeve nga testi (60%) 60 pikë
- Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" – Kaçanik

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr. i Paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	Elektroteknikë	-Teknik i telekomunikacionit - Teknik i informatikës - Instalues elektrik	1 1 1	32 32 24
2.	Ekonomi	- Banka dhe sigurime - Asistent i marketingut	1 1	32 32
3.	Makineri	- Transport rrugor - Instalues i ngrohjes qendrore - Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit - Saldator - Automekanik	1 1 1 1 1	32 24 24 24 24
4.	Juridik	-Asistent juridik	1	32
		Gjithsej	11	312

Gjimnazi "Skënderbeu" - Kaçanik

Nr.	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	Shkenca Natyrore	4	128
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	4	128
3.	Gjithsej	8	256

Drejtori i Drejtorisë;
z. Enver Kamishi

